



Data: 25.09.19 Ref.: 1778/190

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 77, të mbajtur më 16.09.2019 mori:

V E N D I M

I. Riakreditoohen programet e studimit të Universitetit të Pejës “Haxhi Zeka” :

- Edukim Artistik në Interpretim BA, 240 ECTS, për periudhën 01.10.2019 – 30.09.2022, me nga 30 studentë për vit akademik.
- Edukim Muzikor MA, 60 ECTS, për periudhën 01.10.2019 – 30.09.2022, me nga 8 studentë për vit akademik.

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

I. Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programeve të studimit të cekura në dispozitivin I të këtij vendimi.

AKA ka organizuar vizitën me ekspertë ndërkombëtar të akreditimit në Universitetin e Pejës “Haxhi Zeka” më datë 09.07.2019 me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit më këtë përbërje: Prof. art. Marina Novak dhe Mikus Dubickis (student expert).

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 16.09.2019 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Pejës “Haxhi Zeka” dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimin përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me programin e studimit Edukim Artistik në Interpretim BA, raporti i ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit, konstaton se Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka" përmbush në mënyrë substanciale kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit. Ekspertët kanë konstatuar se nga gjithsej shtatë (7) kapituj të standardeve të Manualit të akreditimit, Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka" i plotëson substancialisht katër (4) kapituj, ndërsa i plotëson pjesërisht tre (3) kapituj, dhe rrjedhimisht rekomandon riakreditimin e këtij programi.

Në lidhje me programin e studimit Edukim Muzikor MA, raporti i ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit, konstaton se Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka" përmbush në mënyrë substanciale kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit. Ekspertët kanë konstatuar se nga gjithsej shtatë (7) kapituj të standardeve të Manualit të akreditimit, Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka" i plotëson substancialisht katër (4) kapituj, ndërsa i plotëson pjesërisht tre (3) kapituj, dhe rrjedhimisht rekomandon riakreditimin e këtij programi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Pejës "Haxhi Zeka"
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

